# DËSHMI ARKIVI

**A-456694**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ndahet nga jeta Sandro Mazzola, ikona e Interit dhe legjenda e futbollit italian |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/19/ndahet-nga-jeta-sandro-mazzola-ikona-e-interit-dhe-legjenda-e-futbollit-italian/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 05:28:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 shtator 2026, 05:20:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 19 shtator 2026, 05:19:00 UTC → 19 shtator 2026, 05:21:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9fe71e787942ac292aa797af5990c17368bae49ffe0f1f5af42cb61e4fe649ee` |
| TEKSTI | `94a128c14c21f3a6206033df14b3a243671c914038a73d33b693e05b83ea2f6f` |
| PAMJA | `c7a5fd052464f263475e131a76be9a32c27d70e66465b88ae9b7db64ff2141a6` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2e5c2f75f8de57581398a64e1efc05c0e713af8661f19a1835889598cc7a9c23` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e6c574448d79b56ea5b00fdfb7279f3cc9da68044f16aa3bb2083dd471221c6d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2e5c2f75f8de57581398a64e1efc05c0e713af8661f19a1835889598cc7a9c23`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ndahet nga jeta Sandro Mazzola, ikona e Interit dhe legjenda e futbollit italian

19/09/2026 07:20




**Futbolli italian është në zi. Sandro Mazzola, një prej figurave më të mëdha në historinë e Interit dhe të kombëtares italiane, është ndarë nga jeta në moshën 83-vjeçare. Një emër legjendar i futbollit italian, Mazzola do të mbetet i paharruar për kontributin e tij me fanellën zikaltër dhe atë të Italisë.**

I lindur në Torino dhe i rritur mes dhimbjes së humbjes së babait të tij, Valentino Mazzola, kapitenit legjendar të "Grande Torino", Sandro arriti të ndërtonte një karrierë madhështore, duke e kthyer mbiemrin Mazzola në një simbol të futbollit italian.

**Nga "Veleno" te debutimi me Interin**

Talenti i tij u zbulua nga Benito Lorenzi, sulmuesi i famshëm i Interit i njohur me nofkën "Veleno". Mazzola iu bashkua akademisë së klubit zikaltër, ku pati mundësinë të punonte edhe nën drejtimin e Giuseppe Meazzës.

Shumë shpejt, talenti i tij bëri që dyert e ekipit të parë të hapeshin. Në atë periudhë, Interi drejtohej nga trajneri argjentinas Helenio Herrera, i cili do të luante një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Mazzolës.



**Debutimi i veçantë dhe epoka e "Grande Inter"**

Debutimi i Mazzolës në Serie A lidhet me një prej episodeve më të pazakonta të futbollit italian.

Më 10 qershor 1961, Interi u përball me Juventusin në një ndeshje të zhvilluar në kuadër të protestës së klubit zikaltër, me presidentin Angelo Moratti që vendosi të aktivizonte një formacion të përbërë kryesisht nga lojtarë të rinj. Juventusi fitoi me rezultatin e thellë 9-1, por 18-vjeçari Mazzola shënoi golin e vetëm të Interit nga pika e bardhë.

Pas atij takimi, Herrera i besoi gjithnjë e më shumë të riut, i cili gradualisht u shndërrua


## SPORT • KRYESORE



Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito



Chelsea dorëzohet pa kushte, Brentford dhuron spektakël në Premier League



Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin për Italinë




Teuta mbretëron në Shkodër, Vllaznia zhytet edhe më shumë në krizë



Mbreti i Mynihut shkruan historinë e Bundesligës, 100 gola në vetëm 98 ndeshje!

## ME TË LEXUARAT

Mancini hap epokën e dytë me Italinë, 9 debutues dhe një rikthim surprizë

Eksodi te Kosova vazhdon, dy lojtarë të tjerë i japin fund aventurës me përfaqësuesen dardane pas Rrahmanit dhe Hadërgjonajt

Yamal nuk kursehet, sulmon Kane

nga një qendërsulmues në një mesfushor ofensiv me teknikë të shkëlqyer dhe vizion të jashtëzakonshëm për lojën.

Mazzola qëndroi te Interi deri në vitin 1977, duke zhvilluar 572 ndeshje dhe duke shënuar 162 gola në të gjitha kompeticionet.

**Me fanellën zikaltër ai fitoi:**

- 4 tituj kampionë të Italisë;
- 2 Kupa të Kampionëve;
- 2 Kupa Interkontinentale.

Ai ishte një prej protagonistëve kryesorë të periudhës së artë të Interit të Helenio Herrerës, skuadrës që hyri në histori si "Grande Inter".

**Kombëtarja italiane dhe rivaliteti me Gianni Riverën**

Mazzola debutoi me kombëtaren italiane më 12 maj 1963, në San Siro, në fitoren 3-0 ndaj Brazilit të Pelés. Ai shënoi edhe një prej golave të takimit nga pika e penalltisë.

Pas zhgënjimit të Botërorit të vitit 1966, Mazzola u bë një prej figurave kryesore të Italisë së rindërtuar nga trajneri Ferruccio Valcareggi.

Në atë periudhë lindi edhe një prej historive më të famshme të futbollit italian: "staffetta" mes Sandro Mazzolës dhe Gianni Riverës.

Dy yjet, njëri i Interit dhe tjetri i Milanit, përfaqësonin dy prej figurave më të mëdha të futbollit italian të asaj kohe. Valcareggi shpesh i aktivizonte në role të ndryshme dhe alternonte mes tyre, duke krijuar një prej rivaliteteve më të diskutuara të futbollit italian.

Së bashku me Italinë, Mazzola fitoi Kampionatin Europian të vitit 1968 dhe arriti finalen e Kupës së Botës në Meksikë, në vitin 1970.

Në atë Botëror, Italia eliminoi Gjermaninë Perëndimore në gjysmëfinalen legjendare të njohur si "Ndeshja e Shekullit", e fituar 4-3 pas kohës shtesë, përpara se të mposhtej nga Brazili në finale.

Karriera e Mazzolës me kombëtaren përfundoi pas Botërorit të vitit 1974. Ai regjistroi 70 paraqitje dhe 22 gola me fanellën e Italisë.



**Nga fusha e blertë në zyrat e Interit**

Pas tërheqjes nga futbolli i luajtur në vitin 1977, lidhja e Mazzolës me Interin nuk u ndërpre. Ai vijoi të shërbente në role drejtuese, ndërsa gjatë karrierës së tij administrative pati edhe eksperienca te Genoa dhe Torino.

Një prej lëvizjeve më të bujshme që lidhen me emrin e tij si drejtues ishte transferimi i Ronaldo Nazários, "Fenomenit", te Interi në vitin 1997.

Braziliani u shndërrua më pas në një prej futbollistëve më të dashur në historinë moderne të klubit dhe transferimi i tij mbeti një prej goditjeve më të rëndësishme të merkatos së Interit.




dhe Mbappe: Topi i Artë është për më të mirin, jo për golashënuesin dhe fituesin e Championsit

Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito

Ndërhyrja e Trump dhe çmimi i shpikur, pse Gjermania kërkon shkarkimin e Infantinos

"Kylian do të jetë kapiteni im", Zidane flet për Mbappé, Benzeman dhe Topin e Artë

Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin për Italinë

Ronaldo grumbullohet sërish pas Botërorit, CR7 do të luajë ndeshjet e radhës me Portugalinë në Ligën e Kombeve

Revolucion te Holanda, Xavi Hernandez shpall grumbullimin e tij të parë si timonier i "Tulipanëve"

Teuta mbretëron në Shkodër, Vllaznia zhytet edhe më shumë në krizë

**Një emër që mbetet në historinë e Interit**

Sandro Mazzola nuk ishte thjesht një futbollist i madh. Ai ishte një nga simbolet e një epoke të artë të futbollit italian.

Nga pesha e mbiemrit të trashëguar prej babait të tij Valentino, te netët e mëdha me Interin dhe kombëtaren italiane, Mazzola ndërtoi një histori krejtësisht të tijën.

Fanella zikaltër, trofetë, golat dhe përballjet e paharrueshme të viteve '60 dhe '70 e vendosën emrin e tij përgjithmonë në historinë e futbollit italian.

Një legjendë largohet, por historia e Sandro Mazzolës mbetet.

**Top Channel**

## Futboll »



Mbreti i Mynihut shkruan historinë e Bundesligës, 100 gola në vetëm 98 ndeshje!

18/09 23:18



Chelsea dorëzohet pa kushte, Brentford dhuron spektakël në Premier League

18/09 22:58



Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito

18/09 22:49



Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin për Italinë

18/09 22:47



Festival në Mynih, Bayern "masakron" Union Berlin me 7 gola

18/09 22:35



Teuta mbretëron në Shkodër, Vllaznia zhytet edhe më shumë në krizë

18/09 20:43

## Kryesore »



SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim

19/09 07:13



Vranësira dhe reshje të dobëta në verilindje e lindje, ja moti për ditën e sotme

19/09 07:06



Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito

18/09 22:49



Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin për Italinë

18/09 22:47



JPMorgan: Nuk e dimë se si do të përfundojë lufta SHBA-Iran/ Analistët për "The Guardian": Tregu është në ankth për çmimin e naftës

18/09 22:40



Festival në Mynih, Bayern "masakron" Union Berlin me 7 gola

18/09 22:35

## Serie A »







Rocchi nën hetim për mashtrim sportiv, Prokuroria kërkon arkivimin, ja çfarë zbuluan hetuesit
18/09 18:15

Bonucci rrëfen prapaskenat, nga refuzimi i Guardiolës, sëmundja e djalit dhe gabimi me Milanin
18/09 17:11

Roma-Inter/ Gasperini ul entuziazmin para supersfidës: Ata janë skuadra më e fortë në Serie A, shifrat e tregojnë superioritetin
18/09 14:53


Surprizë te Spanja, De la Fuente grumbullon portierin e Interit pavarësisht gabimeve të fundit
18/09 12:31


Milani nis reflektimin pas humbjes me Benficën, drejtuesit e klubit marrin vendimin për Ruben Amorim
18/09 10:37


Juventus, Massara konfirmon Spallettin: Skuadra është në duar të sigurta, kemi besim të plotë
17/09 21:46

## Sport »


Mbreti i Mynihut shkruan historinë e Bundesligës, 100 gola në vetëm 98 ndeshje!
18/09 23:18


Chelsea dorëzohet pa kushte, Brentford dhuron spektakël në Premier League
18/09 22:58


Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito
18/09 22:49


Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin për Italinë
18/09 22:47



Festival në Mynih, Bayern "masakron" Union Berlin me 7 gola
18/09 22:35


Teuta mbretëron në Shkodër, Vllaznia zhytet edhe më shumë në krizë
18/09 20:43

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Protestë madhështore në Prishtinë, mijëra në shesh kundër vendimit të Hagës


Top Channel/ Macron: Do ti përgjigjemi Rusisë për sulmet hibride që po kryen


Top News- Macron paralajmëron Rusinë: Do merrni përgjigje!/ Kush po i bën sulmet hibride në Evropë?


Top Channel/ Rikthehet kriza e Ceutas, mijëra emigrantë janë kthyer në plazhe


Top Channel/ Protesta në ditën e 111, organizatorët kërkojnë vendime të përbashkëta


Top News- Deklasifikohen të tjera dokumente për UFO-t, dalin video e imazhe



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.